


ANALIZË E SHKURTËR

KONSENSUSI I BRENDSHËM SI PARAKUSHT PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

NËNTOR, 2019



E drejta e autorit © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Përgatitën: **Jeta Krasniqi, Eugen Cakolli** dhe **Violeta Haxholli**

Layout and design: **envinion**

Vërejtje: Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit "*Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë*", i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

- 4** I. HYRJE
- 6** II. QËNDRIMET E SPEKTRIT POLITIK LIDHUR ME FAZËN PËRMBYLLËSE TË DIALOGUT
- 8** III. ARRITJA E KONSENSUSIT POLITIK PËR ASPEKTE TË CAKTUARA TË DIALOGUT
- 10** IV. EFEKTET E (MOS)ARRITJES SË KONSENSUSIT POLITIK
- 11** V. REKOMANDIMET



I. HYRJE

Në vitin 2017, qeveria e re e drejtuar nga Ramush Haradinaj nuk ushtroi rolin e saj kushtetues në procesin e dialogut me Serbinë. Këtë përgjegjësi ia delegoi Presidentit të vendit, Hashim Thaçi, me anë të një vendimi të Qeverisë në të cilin bëhej gjithashtu thirrje për formim të një delegacioni shtetëror.¹ Ndonëse ky vendim nuk arriti të materializohet në një rezolutë të Kuvendit, për shkak të kundërshtimit të partive opozitare, roli i Presidentit si udhëheqës i procesit të dialogut mbeti i pakontestuar nga partitë në pozitë deri në momentin kur ideja e “korigjimit të kufijve” filloi të mbështetej dhe proklamohet nga Presidenti Thaçi.

Me shpërfaqjen e kësaj ideje, dolën në pah edhe dallimet në qëndrime në mes dy krerëve institucional por dhe më gjerë brenda spektrit politik. Një pjesë e tyre filluan angazhimin për ndërtimin e një delegacioni shtetëror që do të përfaqësonte shtetin e Kosovës në këto bisedime², ndërsa pjesa tjetër, e përbërë nga dy partitë më të mëdha opozitare, kërkuan rilegjitimim të qeverisë dhe parandalim të veprimeve të Presidentit Thaçi.³

Stabiliteti politik në vend pësoi dhe një goditje kur më 21 nëntor të vitit 2018, Qeveria mori vendimin për vendosjen e taksës 100% ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, si rezultat i fushatës lobuese agresive të Serbisë kundër Kosovës, si dhe barrierave jo-tarifore të Serbisë ndaj produkteve të Kosovës⁴. Ndaj kësaj mase, Serbia u kundërpërgjig me tërheqje nga procesi i dialogut duke refuzuar rikthimin në tryezën e negociatave deri në heqjen e taksës.

Pozicionimi i faktorit ndërkombëtar kundër taksës 100% dhe presioni ndaj Qeverisë për pezullimin e të njëjtës, shkaktoi përçarje edhe në mes partnerëve të koalicionit qeverisës, me PDK-në që ishte pro pezullimit të taksës⁵ dhe AAK-në që ishte kundër. Kjo çështje përkeqësoi edhe më tej raportet në mes të Haradinajt dhe Thaçit, me këtë të fundit që kërkonte reflektim të Qeverisë lidhur me kërkesën për pezullimin e taksës⁶.

1 Shih vendimin e Qeverisë Nr. 01/63 të datës 3 shtator 2018. I qasshëm në: http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/VendimiQeveriseperthemelimineekipitnegociatorperDialog_3shtator2018_twefbfKBJe.pdf [Qasur më 8 nëntor, 2019]

2 Shih Rezolutën mbi procesin e Dialogut për Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të iniciuar nga grupi parlamentar i PSD-së. I qasshëm në: http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/2018_12_18_Rezoluta06-R-015_USUNuUR6vm.pdf [Qasur më 8 nëntor, 2019]

3 Shih transkriptin e Kuvendit të datës 31 tetor 2018. I qasshëm në: http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/trans__2018_10_31_10_7679_al_ATxNvavEw3.pdf [Qasur më 10 nëntor, 2019]

4 Kryeministri Haradinaj kishte dërguar më 28 janar 2019 një letër shpjeguese shteteve të “Quint-it” për vendimin e Qeverisë për vendosjen e taksës 100% dhe kërkesave të Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e kësaj mase. Për më shumë, shih: http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2018/11/Lista-e-mallrave-te-perjashtuara.pdf?fbclid=IwAR2Y6eDIm-Zb088s2P4MXE6KRFh1yHblumB6OhcNDzAY_IJvVkcPC3bëBo [Qasur më 8 nëntor, 2019]

5 Për më shumë, shih: https://www.koha.net/arberi/142112/veseli-proponon-qe-taksa-te-pezullohet-per-120-dite/?fbclid=IwAR36giZ_3arfCzUdV2I9H-D4q7Yp25HD8NuQ60sx_hPf7AMË5UvDidufEv0 [Qasur më 8 nëntor, 2019]

6 Për më shumë, shih: https://kallxo.com/shkurt/thaci-ben-thirrje-per-pezullim-te-taksës/?fbclid=IwAR2RyhRVFdxncju1HZKpo2g_TrpK71Ct-oomobzdtAAeoGkuxÉ4iLEcJfk0 [Qasur më 11 nëntor, 2019]



Mungesa e konsensusit për taksën dhe opsionet për marrëveshjen përfundimtare rezultuan në një pozicion të paunifikuar shtetëror të Kosovës përballë Serbisë dhe partnerëve ndërkombëtarë, ndaj të cilëve Kosova po përçonte mesazhe të ndryshme, si në takime bilaterale ashtu dhe gjatë pjesëmarrjes në samite ndërkombëtare.⁷ Ndërsa, në planin e brendshëm, dallimet konceptuale pamundësuan miratimin e një rezolute me mbështetje të gjerë politike dhe ndërtimin e konsensusit politik të nevojshëm për procesin e dialogut me Serbinë.

Më 15 dhjetor të vitit 2018, në Kuvend u miratua rezoluta e iniciuar nga grupi parlamentar i PSD-së, e mbështetur vetëm nga koalicioni qeverisës – pa përfshirë Listën Serbe. Mbi bazën e kësaj rezolute, u formua Delegacioni Shtetëror në përbërje të partive politike që e përkrahën atë⁸. Ky dokument rezultoi edhe me miratimin e Ligjit për Delegacionin Shtetëror për Dialogun⁹ dhe Platformës për Dialogun¹⁰ më 7 mars të vitit 2019. Megjithatë, as këto dokumente nuk u miratuan me konsensus të gjerë politik. Dy subjektet më të mëdha opozitare, LDK dhe VV, bojkotuan këto iniciativa duke e cilësuar delegacionin shtetëror si jo legjitim, ndërsa kontestuan edhe kushte-

tutshmërinë e vetë ligjit, duke e dërguar të njëjtin për interpretim në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit e shpalli ligjin në tërësi të papajtuësëm me Kushtetutën.¹¹

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Delegacioni Shtetëror pushoi së ekzistuari, ndërsa mbeti e paqartë vlefshmëria juridike e Platformës Shtetërore për Dialogun. Dy muaj pas këtij vendimi, vendi shkoi në zgjedhje të parakohshme parlamentare pas dorëheqjes së Kryeministrit Haradinaj. Si arsye për këtë vendim, Kryeministri Haradinaj artikuloi, në mbledhje të Qeverisë, ftesën për intervistim të cilën kishte pranuar nga Dhomat e Specializuara. Haradinaj gjithashtu publikisht artikuloi edhe presionin ndërkombëtar për pezullimin e taksës¹² si arsye të dorëheqjes së tij. Kërkesa e faktorit ndërkombëtar për pezullim të taksës mbeti konstante edhe gjatë kohës së Qeverisë në dorëheqje ndërsa nevoja për ndërtimin e një konsensusi të gjerë të spektrit politik mbi bazën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese mbeti domosdoshmëri për tu adresuar në të ardhmen.

7 Për më shumë, shih: <https://indeksonline.net/thaci-e-haradinaj-neser-ne-berlin-pa-nje-qendrim-te-dakorduar-institucional/> [Qasur më 8 nëntor, 2019]

8 Rezoluta u përkrah nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe subjektet politike të komuniteteve tjera jo-shumicë, pa përfshirë Listën Serbe.

9 Projektligji për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e Dialogut në Republikën e Serbisë, http://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/145PLperpergjegjesitedelegacshteterorteKosoves-procesiialogjutiutmeSerbine_WqT4NzhB58.pdf [Qasur më 11 nëntor, 2019]

10 Platforma për Dialogun mbi Marrëveshjen Përfundimtare, Gjithëpërfshirëse dhe Ligjërisht të Detyrueshme për Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/PlatformaperDialogunmbiMarreshjenPerfundimtare_shkurt2019_g8GcYDjuNF_ELbd2KfpmL.pdf [Qasur më 8 nëntor, 2019]

11 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për Delegacionin Shtetëror, 27 qershor 2019, http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf [Qasur më 8 nëntor, 2019]

12 Për më shumë, shih: https://telegrafi.com/haradinaj-shtetet-e-quint-presion-e-detyruan-qeverine-qe-te-jape-doreheqje/?fbclid=IéAR3lYCizuroBVN1FFxct07_kë7bQqBH-USStoë2ghrt_7ëP4iYanuYJN024 [Qasur më 8 nëntor, 2019]



II. QËNDRIMET E SPEKTRIT POLITIK LIDHUR ME FAZËN PËRMBYLLËSE TË DIALOGUT

Konstelacioni i ri politik i krijuar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit, që pritet të sjellë një koalicion qeverisës të përbërë nga opozita e kaluar, paraqet ndryshim domethënës në dinamikën e zhvillimeve politike në vend. Këto ndryshime pritet të ndikojnë dhe në procesin e dialogut Kosovë-Serbi duke konsideruar qëndrimet e artikuluara prej tyre rreth procesit të deritanishëm të dialogut dhe marrëveshjeve të arritura, nevojës së një qasjeje të re lidhur me formatin dhe temat e diskutimit si dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të një konsensusi politik.

Duke marrë në konsideratë qëndrimet e ndryshme të subjekteve politike, vazhdimi i mungesës së konsensusit në prizmin e dialogut Kosovë-Serbi pritet të shoqërojë edhe koalicionin e ardhshëm qeverisës. Arritja e dakordimit të gjerë politik fillimisht për pezullimin e taksës dhe më pas edhe për opsionet rreth marrëveshjes përfundimtare me Serbinë pritet të jetë e vështirë. Përplasjet politike në mes të udhëheqësve institucional, sidomos Presidentit dhe Kryeministrit të ardhshëm mund të ndikojnë në arritjen e konsensusit mes spektrit politik ndërsa vazhdimi të polarizimeve në qëndrime mund t'i kontribuojnë edhe inatet e vjetra politike dhe kalkulimet partiake. Në fakt, këto të fundit për një kohë të gjatë kanë karakterizuar skenën politike në vend, veçanërisht kur bëhet fjalë për nevojën

e unifikimit të qëndrimeve rreth interesit shtetëror përtej interesave të ngushta partiake.

Përvoja e deritanishme në çështjen e dialogut me Serbinë dëshmon mungesën e gatishmërisë së spektrit politik për ndërtimin e një konsensusi të gjerë politik. Edhe kur ka pasur tentativa për arritje të konsensusit, si ajo e vitit 2012, që rezultoi me emërim të Blerim Shalës nga AAK-ja si koordinator politik për dialogun nga Presidentja e asaj kohe Atifete Jahjaga, ato ishin të limituara vetëm brenda një mandati qeverisës dhe vetëm brenda periudhës fillestare të dialogut.


Vetëm një ndër marrëveshjet e arritura në kuadër të këtij procesi u ratifikua në Kuvend më 19 prill të vitit 2013 si marrëveshje ndërkombëtare. Meqë asnjë marrëveshje tjetër e arritur në kuadër të këtij procesi nuk u soll në Kuvend për ratifikim, mungesa e nevojës për arritjen e konsensusit prej dy të tretave (2/3), nuk i obligoi palët e përfshira në dialog të shkonin përtej deklaratave e thirrjeve për konsensus. Pas vitit 2013 nuk kishte më përfshirje direkte të partive opozitare në proces të dialogut.

Gjithsesi, vlen të theksohet që qëndrimi i spektrit politik në Kosovë, që nga fillimi i këtij procesi, ka shkuar drejt pranimit që dialogu është i pa alternativë, si një ndër pro-





DIALOGU KOSOVË-SERBI NË MASË TË MADHE MUND TË PËRCAKTOJË TË ARDHMEN E KOSOVËS, QOFTË SA I PËRKET PERSPEKTIVËS EURO-ATLANTIKE, POR DHE KONSOLIDIMIN E JASHTËM E TË BRENDSHËM TË SHTETIT TË KOSOVËS.



ceset më të rëndësishme politike¹³ në të cilin kalon Kosova që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008. Sidoqoftë, mospajtimet e spektrit politik që ndërlidhen me aspekte të caktuara të këtij procesi, kanë çuar vendin në kriza të shpeshta politike dhe institucionale.¹⁴

Dialogu Kosovë-Serbi në masë të madhe mund të përcaktojë të ardhmen e Kosovës, qoftë sa i përket perspektivës euro-atlantike, por dhe konsolidimin e jashtëm e të brendshëm të shtetit të Kosovës. Duke konsideruar rëndësinë dhe ndjeshmërinë që ka përmbyllja e procesit të dialogut me Serbinë për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e saj, është tejet e nevojshme që të arrihet një pajtueshmëri mes spektrit politik lidhur me vazhdimin e dialogut, përkatësisht parimet mbi të cilat pala kosovare do ta përmbyllë këtë proces.

Barra e përgjegjësisë për arritjen e konsensusit i bie koalicionit qeverisës të ardhshëm, sidomos subjektit fitues. Ky koalicion do të kenë mundësinë që të gjitha kritikrat e drejtuara ndaj Qeverisë paraprake lidhur me menaxhimin e procesit të dialogut, t'i përkthejë në veprime konkrete qeverisëse. Pa diskutim që ndër të tjera kjo nënkupton përkushtim real për arritje të konsensusit, i përcjellë me transparencë dhe llogaridhënie të plotë.

¹³ Shih qëndrimet e kryetarëve të grupeve parlamentare të artikuluara në tryezën e KDI-së të datës 6 tetor 2017 në, <http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/134> [Qasur më 8 nëntor, 2019]

¹⁴ Për më shumë, shih: <https://kosovotwopointzero.com/tear-gas-eggs-and-protests-seven-things-you-need-to-know-about-kosovos-political-standoff/> [Qasur më 13 nëntor, 2019]





III. ARRITJA E KONSENSUSIT POLITIK PËR ASPEKTE TË CAKTUARA TË DIALOGUT

Formati i dialogut paraqet një nga pikat ndarëse të këtij procesi, duke marrë parasysh mospajtimet e thella që kanë ekzistuar në mes të subjekteve kryesore politike, sidomos sa i përket rolit të Presidentit në këtë fazë, si dhe nevojës për krijimin e një ekipi negociator gjithëpërfshirës. Ndonëse aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje ka sqaruar përfundimisht se Qeveria, respektivisht Kryeministri, është autoriteti i cili duhet ta udhëheqë politikën e jashtme, të njëjtit i kërkohet që zbatimin e politikës së jashtme ta bëjë në konsultim me Presidentin¹⁵. Për më shumë, relacionet mes Presidentit me Kryeministrin në arritjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, siç është kjo që eventualisht mund të arrihet me Serbinë, janë të përcaktuara edhe me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare, i cili kërkon në mënyrë eksplicite autorizimin e Presidentit për ndërmarrjen e veprimeve për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare¹⁶. Pra, përkundër dallimeve eventuale, Presidenti dhe Kryeministri i ardhshëm janë të obliguar që të bashkëpunojnë dhe të koordinohen në funksion të arritjes së një marrëveshje përfundimtare me Serbinë.

Përfshirja e opozitës si pjesë integrale përgjatë tërë procesit mbetet element tejet i rëndësishëm. Ky, në fakt, është

një nga parakushtet kryesore për arritjen e konsensusit të nevojshëm politik për përmbylljen e dialogut me Serbinë. Një marrëveshje eventuale në mes palëve duhet të ratifikohet në Kuvendin e Kosovës me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Opozita e ardhshme, që pritet të përbëhet nga subjektet politike që ishin paraprakisht në pozitë, nuk duhet të konsideroj veten të përjashtuar nga këto përgjegjësi. Nga ajo pritet që natyrshëm të tregojë konstruktivitet në arritjen e një konsensusi politik lidhur me dialogun, për faktin që e njëjta ka qenë bartëse e procesit të deritanishëm të dialogut dhe ka proklamuar nevojën e një konsensusi politik lidhur me këtë temë. Por, lidhur me këtë, nuk duhet anashkaluar fakti që arritja e konsensusit nuk duhet assesi të interpretohet apo shfrytëzohet nga palët si mundësi për bllokimin e procesit.

Dimensionit kohor në arritjen eventuale të marrëveshjes me Serbinë është një çështje tjetër mbi të cilën nevojitet konsensus i brendshëm politik. Edhe pse ky aspekt nuk qëndron i pavarur karshi zhvillimeve në arenën ndërkombëtare, tërë spektrit politik në Kosovë do t'i duhet një dakordim lidhur me afatet kohore brenda të cilave do të arrihet një marrëveshje, pasi që, kjo do të përcaktojë në masë


15 Për më shumë, shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KO43/19. I qasshëm në: http://gjk-ks.org/ëp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf [Qasur më 8 nëntor, 2019]

16 Për më shumë, shih nenin 7, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2789> [Qasur më 13 nëntor, 2019]





ÇËSHTJE TJETËR MJAFT E RËNDËSISHME JANË EDHE



STATUSI JURIDIK I Pjesës më të madhe të së cilave vazhdon të mbetet i padefinuar qartazi meqë vetëm Marrëveshja e Parë e Parimeve është ratifikuar në Kuvend të Kosovës si marrëveshje ndërkombëtare ndryshe nga marrëveshjet e tjera.

të madhe edhe kualitetin e marrëveshjes eventuale. Një konsensus i tillë lidhur me afatet kohore, duhet patjetër t'i shërbejë përgatitjeve të institucioneve përgjegjëse për përfaqësimin sa më cilësor të Kosovës në dialog. Kësaj i shtohet fakti që praktikata e deritanishme kanë treguar që edhe kur proceset negociuese kanë zgjatur, të njëjtat nuk janë shoqëruar me përgatitje të mirëfilltë të palës kosovare në artikullimin e qëndrimeve e kërkesave të saja dhe gatishmërisë së spektrit politik për ta përmbyllur atë.

Ndonëse ekziston një pajtim "i heshtur" në mesin e spektrit politik kosovar lidhur me **temat** që duhet të jenë pjesë e dialogut, mbetet ende e rëndësishme nevoja për ndërtimin e një qëndrimi unik dhe dokumenti të përbashkët strategjik lidhur me bisedimet në mes Kosovës dhe Serbisë. Draft marrëveshja e përpiluar nga ana e Qeverisë Haradinaj, si dhe Platforma për Dialogun, e votuar nga Kuvendi i Kosovës, nuk arritën të kenë mbështetje të të gjithë spektrit politik ndërsa vet statusi i kësaj të fundit pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbeti i paqartë. Ndërmarrja e një iniciative të tillë duhet të jetë padyshim e Qeverisë, që duhet të marrë parasysh dhe të reflektojë kërkesat dhe pikëpamjet e qytetarëve lidhur me temat që duhet të jenë pjesë e dialogut.

Çështje tjetër mjaft e rëndësishme janë edhe **33 marrëveshjet e arritura** deri më tani, statusi juridik i pjesës më të madhe të së cilave vazhdon të mbetet i padefinuar qartazi meqë vetëm Marrëveshja e Parë e Parimeve është ratifikuar në Kuvend të Kosovës si marrëveshje ndërkombëtare ndryshe nga marrëveshjet e tjera. Diskutimet rreth nevojës së vlerësimit të procesit të deritanishëm dhe rivlerësimin e vet marrëveshjeve të deritanishme mund të jenë "mollë sherri" brenda koalicionit eventual qeverisës dhe vet procesit të dialogut, marrë parasysh paqartësinë lidhur me efektin përfundimtar që synohet të arrihet me rivlerësimin e marrëveshjeve.

Gjatë mandatit të fundit qeverisës, Kosova ka paraqitur pozicionin e saj bazuar në teza të ndryshme nga krerë institucional duke dëmtuar kështu pozitën e Kosovë në bisedime por dhe fuqinë e saj për të shtyrë përpara interesat e saj. **Lobimi mbi bazën e një qëndrimi unik** duhet të shoqërojë këtë proces që nga hapat e parë, ndryshe nga praktikata e gabuara të së kaluarës. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës duhet të angazhohen me anë të një diplomacie lobuese për kërkesat dhe qëndrimet e palës kosovare në kuadër të këtij procesi, duke targetuar kryeqendrat botërore, por dhe duke qenë prezent në secilën tryezë diskutimi formale dhe jo formale ku diskutohet rreth zgjidhjes Kosovë-Serbi, dhe të ardhmes evropiane të Ballkanit Perëndimor.





IV. EFEKTET E (MOS)ARRITJES SË KONSENSUSIT POLITIK

Arritja e konsensusit politik në faza dhe aspekte të caktuara të dialogut do të sillte padyshim avantazhe shumëdimensionale për Kosovën. Nga procesi i dialogut pritet të përcaktohen raportet mes dy vendeve që kanë qenë pjesë e një konflikti shumëvjeçar, raportet ndëretnike mes dy shoqërive, duhet vënë bazat e marrëdhënieve të paqes dhe stabiliteti të brendshëm të dy vendeve dhe atë rajonal.

Në planin e brendshëm, arritja e konsensusit do të reflektonte një pajtueshmëri të gjerë edhe të publikut për përmbylljen e dialogut me Serbinë, andaj rrjedhimisht do të evitonte situatat e kundërshtimit, madje edhe në forma të dhunshme, të një marrëveshje eventuale. Ndërsa, në planin e jashtëm, qëndrimi i unifikuar i Kosovës në dialog, si derivat i arritjes së konsensusit të brendshëm politik, do të forconte në rend të parë pozitën negociuese të Kosovës në raport me Serbinë, por edhe do të lehtësonte iniciativat për lobim në vendet e treta. Këto elemente janë tregues të qartë për rëndësinë dhe nevojën e gjetjes së një qëndrimi të përbashkët të subjekteve politike për procesin e dialogut, që shkon përtej pikëpamjeve dhe qëndrimeve ditore politike.

Mirëpo, në anën tjetër, *cilat do të ishin pasojat e mosarritjes së një konsensusi të tillë politik?*

Së pari, në rast se spektri politik nuk arrin të ndërtojë një qëndrim të unifikuar shtetëror lidhur me dialogun me Serbinë, mbi bazë kompromisi, pashmangshëm do të kishte polarizim të spektrit politik, e që nëse merret parasysh ndjeshmëria e këtij procesi, atëherë është lehtë të

konkludohet që polarizimi në nivelin politik do të shpinte edhe në **polarizim shoqëror**, që mbart në vete rrezikun e trazirave qytetare.

Sa i përket funksionimit të rregullt të jetës institucionale, përvoja e kaluar tregon që mungesa e konsensusit lidhur me çështjet e interesit nacional mund të ndikojë në **paralizimin e jetës institucionale, e veçanërisht asaj parlamentare**. Madje, ky rrezik mund të jetë evident, edhe në rast se shumica parlamentare përbëhet nga numër i konsiderueshëm i deputetëve. Shumica i kanë të freskëta skenat e gazit lotsjellës në Kuvend, të cilat kishin ardhur edhe si rezultat i një marrëveshje të arritur në kuadër të procesit të dialogut, e cila ishte kundërshtuar nga opozita e atëhershme.

Kur flasim për jetën parlamentare, në mungesë të konsensusit të nevojshëm, nuk mund të përjashtohet mundësia e arritjes së **një marrëveshje e cila nuk mund të kalohet në Kuvend** si dhe **mungesa e qëndrimit unik** të palës kosovare kundrejt Serbisë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Kjo do ta paraqiste Kosovën si palë jo konstruktive edhe në arenën ndërkombëtare, por dhe si palë që nuk arrin të përmbushë zotimet që e marra parapakisht. Kosova do të dëmtohej edhe sa i përket pozitës dhe fuqisë negociuese, që do të zbehej ndjeshëm.





V. REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të gjeturat e kësaj analize, si dhe marrë parasysh rëndësinë që ka konsensusi i brendshëm politik në raport me procesin e dialogut, si procesi më i ndjeshëm politik në të cilin po kalon Kosova, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ofron rekomandimet si në vijim:



QEVERIA E RE duhet të intensifikojë përpjekjet për arritjen e konsensusit në mes të spektrit politik lidhur me të gjitha fazat e dialogut për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, duke përfshirë atë parapërgatitore, përgatitore, përcaktimin e agjendës dhe opsionet mbi marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Konsultimet duhet të zhvillohen mbi bazën e mirëbesimit, duke vendosur në plan të parë interesin e shtetit të Kosovës.



SUBJEKTET OPOZITARE duhet të jenë po aq të përgjegjshme për arritjen e konsensusit për çështje të interesit shtetëror. Ato duhet të tregojnë përkushtim dhe konstruktivitet në mënyrë që të tejkalohen pengesat në arritjen e pajtueshmërisë.



PRESIDENTI DHE KRYEMINISTRI I VENDIT, konform përgjegjësi të tyre kushtetuese duhet të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i kontribuojnë ndërtimit të konsensusit politik lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi.



